

RAPORT

nga Sali Berisha

E VËRTETA E NON GRATA-S TË SALI BERISHËS

Korrupsioni transnacional
i zyrtarve si armë
për të shkatërruar opozitën

- Variant i shkurtër -

Tiranë, korrik

2023

RAPORT¹

(Varianti i Shkurtër)

E VËRTETA E NON – GRATA – s SË SALI BERISHËS

Korrupsionit transnacional i zyrtarve si armë për të shkatërruar opozitën.

Nga Sali Berisha

Ish President, ish kryeministër, kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë me prova, fakte e dokumenta të pakundërshtueshme, nga pozicioni i dëshmitarit, përdorimin e korrupsionit politik transnacional – korrupsionin e diplomatëve dhe zyrtarëve të huaj nga qeveria shqiptare – dhe angazhimin e tyre në luftën kundër opozitës, për shkatërrimin e saj.

Me datë 19 Maj 2019, Sekretari i Shteti Blinken më shpalli mua non grata pa asnjë provë, fakt apo dokument, Ky vendim vinte 8 vite pasi unë kisha dhënë dorëheqjen nga çdo funksion apo rol drejtues. Po atë ditë unë i drejtova atij një letër², në të cilën i shkruaja:

-Se vendimi i tij ishte politik dhe kishte në bazë lobimin korruptiv të Edi Rames dhe mbrojtësit të tij George Soros dhe,

-se në momentin që ai apo çdo qeveri tjetër në botë do të paraqesë një provë të vetme për korrupsionin tim, unë do largohem në mënyrë përfundimtare nga politika.

Me datë 21 Maj 2021, unë për të mbrojtur dinjitetin tim padita në gjykatën e Parisit për shpifje Sekretarin Blinken³.

Më 21 Korrik 2022, Edi Rama deklaroi në parlament se unë nuk do të mund t'a kaloja më La Manshe-in. Tre orë më vonë, unë mora një letër konfidenciale nga ambasada Britanike, në të cilën Home Office më njoftonte se kishte vendosur përjashtimin tim nga Britania e Madhe, me akuzat

¹ Korrespondencat dhe anekset e referuara më poshtë në këtë raport, që janë pjesë e shkëmbimeve zyrtare me autoritetet britanike, mund të gjenden pranë <https://www.sali-berisha.com/ukdocumentsarchive>

² https://botapress.info/lajmerohet-sali-berisha-i-shkruan-leterpergjigje-sekretarit-amerikan-antony-blinken/?fbclid=IwAR0Zy7iiz4cJeBpCOdsMuw-8zboi11vZ5px_djX6WMN8XpSoKEBmOroMNMQ

³ [Former Albanian President to sue US State Secretary Antony Blinken – EURACTIV.com](https://www.euractiv.com/en/former-albanian-president-to-sue-us-state-secretary-antony-blinken/)

për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar, për të cilat unë paraqisja rrezik për sigurinë e Mbretërisë së Bashkuar (shtojca 1).

Menjëherë denoncova vendimin si vendim politik, i cili, njëlloj si vendimi i Sekretarit Blinken, bazohet fund e krye në gënjeshtër nga mediat e sponsorizuara nga Soros, si dhe trillime të kundërshtarëve të mi politikë Edi Rama, Erion Velia, e Lulzim Basha⁴.

Një mision faktmbledhës I Këshillit të Ambasadorëve Amerikanë, vizitoi Shqipërinë në Maj të vitit 2023 dhe botoi së fundmi një raport (të cituar më poshtë në këtë dokument), në të cilin theksohet se atyre nuk iu dhanë prova në lidhje me korrupsionin e pretenduar të z.Berisha dhe se procesi I dezinjimit të tij nuk reflekton drejtësinë amerikane dhe është ndoshta unik në jurisprudencën amerikane. Gjer më sot, Departamenti i Shtetit nuk ka paraqitur asnjë prove, fakt apo dokument të vetëm përvendimin e tij pa baza. Kjo thjesht sepse ato nuk ekzistojnë.

Ndaj, këtu më poshtë, unë do t'u njoh me dokumentet që Home Office ka paraqitur për të provuar akuzat ndaj meje, gjatë procesit ligjor që ka nisur pas padisë sime. Këto dokumenta provojnë qartë se vendimi ka në bazë shpifjet dhe shtrëmbërimet e mediave të George Soros kundër meje, si dhe deklarata të kundërshtarëve të mi politik, të serviuara si të vërteta tek Home Office, nëpërmjet korrupsionit të ambasadorit britanik në Shqipëri, z. King Smith dhe paraardhësit të tij z. Norman Duncan.

Le ti analizojmë me rradhë.

Sipas Home Office lidhjet e mia me krimin e organizuar provohen nga:

1-Lidhjet e supozuara me Fation Dautin, person i përzënë nga Britania e Madhe, të cilin unë nuk e kam takuar kurrë dhe nuk kam patur kurrë ndonjëherë lidhje me të. Burimi i informacionit: Lulzim Basha.

Me 20 janar 2022, ky person i pranishëm në selinë e PD në mesin e 150 të tjerëve, goditi me shqelm një derë. Ish kryetari i PD, kundërshtar i imi, më akuzoi se kisha lidhje me trafikantë dhe kriminelë, duke iu referuar Fation Dauti dhe se do të njoftonte ambasadat e huaja për këtë. Unë deklarova po atë ditë se nuk e kisha takuar kurrë Fation Dautin dhe se isha informuar pas incidentit për të. Deri më sot askush nuk ka mundur t'a kundërshtojë deklaratën time. Në të vërtetë fakte dhe dëshmi të pakundërshtueshme provonin se Dauti kishte qënë mbështetës i ish kryetarit të PD, Basha. Megjithatë, ambasadori King Smith e përcolli tek Home Office akuzën e Lulzim Bashës si të vërtetë. Ky i fundit, mik i ambasadorit King Smith dhe paraardhësit të tij, i ngecur në rrjetën e problemeve të tij me drejtësinë, në lidhje me akuzat për financimet ruse, bën çdo gjë për të siguruar mos hapjen e dosjes së tij gjyqësore nga Edi Rama⁵.

Në dokumentat e dorëzuara nga Home Office, **Home Office pranon shprehimisht**, disa here, se nuk ka mundur të provojë se ka lidhje midis Sali Berishës dhe Fation Dautit⁶.

⁴ Shih paragrafet 6-7 të raportit (variant i zgjeruar).

⁵ Sipas një raporti të komunitetit inteligjent të SHBA, të bërë publik së fundmi, Lulzim Basha kishte pranuar në vitin 2017 financime Ruse prej 720 mijë dollarësh, gjë për të cilën prokuroria i hapi hetim. Hetimi përfshiu edhe akuza për larje parash por prokurori përdori një manovër teknike për të mbyllur dosjen e tij, me ndërhyrjen direkte të Ramës. Në kundërshtim me ligjin dosja nuk kaloi për gjykim në Gjykatën e Lartë, por ajo mund të rihapet në çdo moment, gjë që e bën Bashën peng të Edi Ramës. Për referenca shih raportin (variant i zgjeruar) §36.7

⁶ Aneksi D §42: "It is noted that it has not been possible to sufficiently prove that BERISHA has personal connections to DAUTI.". Po kështu shih Aneks D§25, si dhe paragrafet 8-8.3, 36.6 – 36.8, të raportit (variant i zgjeruar).

2- Lidhjet e mia me Damir Fazliç, për të cilin, sipas Home Office, unë kam ndërhyrë kur për atë kanë dalë prova inkriminuese. Burimet: Rrjeti BIRN/Balkan Insight/Reporter.al, të George Soros

Damir Fazliç është biznesman, shtetas britanik i cili nuk ka qënë kurrë i inkriminuar apo dënuar në Shqipëri, në MB dhe në dijenine time as në ndonjë vend tjetër. Ndaji tij, në Shqipëri, nuk kanë dale kurrë prova të veprimtarive inkriminuese, gjatë kohës kur unë kam qënë kryeministër apo më vonë. Prokuroria shqiptare në vitin 2009 hapi një hetim ndaj tij, për shkak të presionit mediatik të PS, pasi Fazlic kishte transferuar para nga një llogari offshore për blerjen e një toke private. Një transferim i tillë nuk ishte i ndaluar nga legjislacioni shqiptar dhe hetimi u mbyll, për mungesë provash. Gjatë hetimit, prokuroria kërkoi në një moment ndalimin e tij, pa urdhër të shkruar ligjor, gjë që u refuzua nga organet ligjzbatuese pasi binte në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale dhe garancitë e Kushtetutës së Shqipërisë. Kur prokuroria dërgoi ftesë me shkrim Fazlic u paraqit menjëherë sipas të gjitha rregullave. Shtoj këtu se Damir Fazliç, i cili vazhdon edhe sot biznesin në Shqipëri, kurrë nuk ka përfutuar një qindarkë nga qeveria e PD si dhe kurrë nuk më ka sponsorizuar mua apo PD⁷.

3-Lidhjet e mia me bandën e Elbasanit. Burimi: Lulzim Basha⁸.

Edhe në këtë rast ambasadori Britanik ka percjellë tek Home Office një shpifje të radhës të ish-kryetarit të PD Lulzim Basha, i cili në nëntor të vitit 2022 deklaroi se Berisha po mbledh firmat e delegateve të Elbasanit, për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të PD, me ndihmën e Suel Çeles. Unë iu përgjigja këtij trillimi të turpshëm menjëherë publikisht, duke nxjerrë fakte që demonstrojnë të kundërtën: denoncimet e mia të vazhdueshme, me emra të të gjithë banditëve dhe bandave të Elbasanit. Personalisht Çelen, bandat e Elbasanit dhe çdo bandë tjetër të vendit, i kam denoncuar publikisht gjatë viteve në opozitë me dhjetëra dhe qindra herë. Shtoj këtu se për shkak të suksesit të qeverisë së PD në luftën me zero tolerancë ndaj krimit të organizuar, Shqipëria u anëtarësua në NATO, firmosi marrëveshjen e stabilizim asociimit, liberalizoi vizat me BE, mori rekomandimin e Komisionit Europian për statusin e vendit kandidat. Në të gjitha këto vendim-marrje, Britania e Madhe ka votuar në favor të Shqipërisë. Bashkëpunimi i ngushtë i qeverisë së PD me autoritete ligjzbatuese britanike, në luftë kundër krimit të organizuar, duke përfshirë dhe operacionet e fshehta të përbashkëta, është vlerësuar lart nga përfaqësues të Mbretërisë së Bashkuar. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Krimit të Rëndë dhe të Organizuar (SOCA), Bill Hughes, në shtator 2009 deklaroi në Tiranë se: “Ju jeni një aleat i vlefshëm i Britanisë së Madhe në luftën kundër krimit të organizuar”. dhe se "ne do të kërkojmë që modeli i bashkëpunimit me ju të shtrihet edhe në vende të tjera"⁹.

Në dokumentat e dorëzuara, **Home Office pranon** se nuk ka mundur të vërtetojë lidhjet e mia me bandat kriminale, por thotë se kjo akuzë mbështetet nga lidhja ime me Fation Dautin, ndonëse më parë ka thënë në mënyrë të përsëritur se nuk ka prova që provojnë lidhjen time me Fation Dautin¹⁰.

⁷ Shih paragrafet 9- 9.4, të raportit (variant i zgjeruar).

⁸ Për referenca të plota shih §10-§17 të raportit (variant i zgjeruar).

⁹ <http://arkiva.km.gov.al/?fq=brenda&m=news&lid=11482&gj=gj2>

¹⁰ Annex D §20: “The CSN Project team have assessed that the reporting indicates that BERISHA has been connected to wider criminality, albeit we assess that these indications require (and gain) support from other sources. Whilst these do not provide concrete evidence of such ties, its weight is to be assessed in combination with the video footage of BERISHA with Fation DAUTI (relied on in the original submission of July 2022), as well as the information found at Annex E. The combination of evidence allows for a reasonable degree of confidence in

Këto ishin të ashtuquajturat prova që Home Office ka paraqitur për lidhjet e mia me krimin e organizuar dhe rrezikshmërinë time për Mbreterinë e Bashkuar.

Po kështu akuzat e Home Office për lidhjet e mia me korrupsionin bazohen tërësisht në trillime të qëllimshme të mediave të George Soros dhe kundërshtarëve të tjerë të mi politik¹¹.

Le ti shqyrtojmë ato me radhë.

1- Akuzohem se kam pasuruar në mënyrë të paligjshme biznesmenin Damir Fazliç për faktin se në vitin 2009 me vendim të KRRTSH është zgjeruar me 810 hektar parku energjistik në Porto Romano. Burimi: Rrjeti BIRN/Balkan Insight/Reporter.al, të George Soros

Kjo është një akuzë qesharke e cila mendoj nuk nderon ata që e përdorin. Parku energjistik i Porto Romanos, i ngritur me 51 hektar në vitin 2001 nga qeveria socialiste, u zgjerua në vitin 2009 për nevoja strategjike të vendit me 810 hektarë, pas një studimi serioz dhe të shumëanshëm, konsultimeve me komunitetin dhe vendim-marrjes së pushtetit lokal e atij qëndror. Në brendi të këtij zgjerimi gjendeshin edhe afro 12 nga 14 hektarë tokë që Damir Fazliç kishte blerë nga pronarë privat. Potenciali dhe planet për zgjerimin e parkut kanë qenë të njohura pasi janë publikuar në fletoret zyrtare dhe mediat kombëtare¹².

2- Një akuzë tjetër bazohet në pretendimin se në vitin 2006, gjatë marrëveshjes midis Albtelekom sh.a, që kontrollohej nga aksioneri privat (76%) dhe një kompanie private Amerikane, Damir Fazliç, sipas një proces verbali pa vulë dhe pa firmë, të hedhur në internet i paska kërkuar 1 milion Dollarë bashkëinvestitorëve për kandidatët në zgjedhjet lokale. Burimi: Rrjeti BIRN/Balkan Insight/Reporter.al, të George Soros

Per ta bërë të besueshme këtë trillim Home Office thotë se në kohën e asaj bisede Albtelekom ishte kompani shtetërore, ndërkohë që ajo ishte privatizuar nga qeveria socialiste në vitin 2004 dhe 76% të aksioneve i kishte kompania turke Calik, e cila kishte dhe ushtri të drejtën e parablerjes së aksioneve të tjera. Vetë autori i artikullit shkruan se nuk u gjet asnjë gjurmë e këtij transaksioni dhe Damir Fazliç në atë shkrim mohon kategorikisht një kërkesë të tillë. Por këto fakte injorohen nga Home Office¹³.

3- Rasti Ansar. Burimi: Rrjeti BIRN/Balkan Insight/Reporter.al, të George Soros.

the conclusion that BERISHA has been connected with criminal actors and serious and organised crime. This is therefore another example of BERISHA having benefitted from criminal activity". See also Annex D\$23, §24, §25\$42.

Annex D\$25: "Consequently, even if it cannot be proved that BERISHA had personal connections to DAUTI, this does not impact on the assessment that he has been connected more widely to criminals and/or organised crime groups".

Shih paragrafet 10 – 17, të raportit (variant i zgjeruar).

¹¹ Shih paragrafet 19 – 20 të raportit (variant i zgjeruar).

¹² Shih citimet e faqeve zyrtare tek paragrafet 21 – 21.3 të raportit (variant i zgjeruar).

¹³ Shih paragrafet 22 – 22.3 të raportit (variant i zgjeruar).

Ky biznesmen dhe konsull nderi i Shqipërisë në Pakistan, i emëruar nga qeveria socialiste, u paraqit tek studio ligjore e vajzës time për të kërkuar mbështetjen e saj ligjore për investimin e tij privat për një TEC në Porto Romano. Që në fillim vajza ime në prani të personave të tretë e sqaroi atë s,e në rast se ai synonte t'a kanalizonte investimin e tij në një PPP, procedurë e cila kërkonte garë të hapur, ajo nuk mund t'i ofronte atij shërbime ligjore, për shkak të konfliktit të interesit. Ai u shpreh se ishte i interesuar të ndiqte rrugën private të investimit. Më pas ai ndryshoi qëndrim dhe kërkoi t'a kanalizonte investimin në PPP por dhe të evitonte garën. Pas refuzimit të prerë të vajzës sime për të ndërhyrë që ai të investonte në një PPP pa garë, ai mashtroi publikisht, duke thënë se atij nuk i ishte pranuar kërkesa, pasi kishte refuzuar tarifat e larta të studios ligjore të vajzës sime dhe se ai nuk pranoi të blinte një tokë që i ishte ofruar nga studio e saj, gjë që ishte krejtësisht e pavërtetë. Vajza ime iu përgjigj publikisht në atë kohë trillimeve të tij, të nxitura nga ata që e kishin emëruar konsull. Ajo shpjegoi se nuk zotëronte ndonjë tokë për të shitur dhe se me kërkesë të z. Ansar ishin angazhuar ekspertë të jashtëm për të lokalizuar tokë sipas kërkesave të tij specifike. Dhoma e Avokatisë deklaroi se tarifat e kërkuara ishin në përputhje me kuadrin rregullues të miratua nga kjo dhomë. Gjykata Kushtetuese dhe gjykatat e tjera të vendit kanë jurisprudencë të konsoliduar që konfirmojnë këto qëndrime¹⁴.

4- Në vazhden e gënjeshtreve të mësipërme, artikujt e BIRN, të sponsorizuar nga Soros, nën tituj bombastikë se po publikojnë pasuritë e vajzës sime dhe llogaritë e saj bankare, paraqesin llogari bankare personale dhe të biznesit të personave të tjerë, aktivitetin tregtar të subjekteve të tjera. Home Office është detyruar të pohojë në mënyrë të përsëritur mashtrimet dhe dobësinë e argumentave të burimit të saj¹⁵.

5 – Rasti Pirro Mishës, ish drejtues i Fondacionit Soros në Shqipëri, sillet po në këtë artikull, të cituar si burim nga Home Office. Ai gënjen haptazi ambasadorin Amerikan duke i thënë se një mosmarrëveshje e zgjatur që ai kishte më një investitor Italian u zgjidh menjëherë në favor të tij sapo kërkoi ndihmën e vajzës sime. Kjo histori nuk ka ndodhur kurrë, por ajo është një nga shembujt e qartë që tregojnë strategjinë e drejtuar të Fondacionit Soros dhe drejtuesve të saj kundër meje.

¹⁴ Shiko Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, vendim no.37, datë 01.12.2022. Për shpjegime të mëtejshme shi paragrafin 23 të raportit (variant i zgjeruar).

https://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php
https://www.gjk.gov.al/templates/NEModules/kerkesa_list/konsulto.php?id_kerkesa_vendimi=3582&language=Lng2

Për referenca të plota mbi këtë çështje shih §23 te Raportit (varianti i zgjeruar)

¹⁵ Annex B, §89: "...Our considered view is that though this conflation weakens the article's argument, it still carries weight...". Annex B§90: "Ms Malltezi also contests two points the article makes based on Wikileaks material reporting to be a US diplomatic cable. The original referral case did not place reliance on any of the Wikileaks material referred to in the Balkan Insight article and which purports to be a US diplomatic cable. We continue not to rely on it. The UK Government can neither confirm nor deny the veracity of the Wikileaks material. We do not therefore provide further comment on these points". Annex B§98: "...However, the article does appear to conflate the three law firms, and so wrongly attributes clients of the law firm (...) to the law firm Malltezi (...)". Annex B, §99: "This conflation weakens the strength of the article's argument because these clients cannot be traced back to a law firm directly run by Ms Malltezi"; Annex D §16/d: "...the media outlet is not infallible". Shih paragrafin 24 të raportit (variant i zgjeruar).

Duke vërtetuar se jo e vërteta, por shërbimi ndaj interesave të Soros dhe Edi Ramës janë funksioni i tyre i vërtetë, në mënyrë militanteske, BIRN/Balkan Insight refuzoi të botonte në kohës e publikimit të shkrimeve, reagimin që vajza ime u dërgoi me email, në të cilën ajo hidhte poshtë me argumenta të gjithë fabrikimet e artikullit (shih emailin bashkangjitur).

6- E mbetur pa asnjë fakt prove apo dokument për të provuar korrupsionin tim, Home Office me akuzon pa asnjë bazë për lidhje, nxitje dhe perfitime nga skemat piramidale të 27 viteve më parë. Burimet: IMF paper, Culture Trip, UnHerd¹⁶

Këto akuza janë shpifje të bazuara në gënjeshtër. E vërteta është se nuk kam patur asnjë lidhje dhe nuk kam perfituar asnjë qindarkë nga këto skema dhe jo vetëm që nuk i kam nxitur ato por përkundrazi (i) unë kam refuzuar prerazi rekomandimin e ekspertëve nga mesi i vitit 1996 për ti licencuar ato si institucione financiare, (ii) kam udhëzuar ngritjen e padisë kundër tyre në gjykatë¹⁷, (iii) kur skemat kolapsuan, kam refuzuar injektimin e parave ‘të mira’ për shpëtimin apo kompensimin e tyre, (iv) Qeveria miratoi ligjin për kontrollin dhe falimentimin e tyre, si dhe (v) u vendosën para drejtësisë boset e tyre. Krizën politike të rebelimit komunist të krijuar nga kriza financiare e zgjidhëm me marrëveshje politike dhe zgjidhje parlamentare. Në fushatën elektorale të vitit 1997, rivali im iu deklaroi shqiptarëve se do iu kthente cdo qindarkë që keni humbur në skema. Kurse unë iu deklarova se nuk mund të kthehej asnjë qindarkë sepse qeveria nuk mund të njohë një borxh që nuk është kontraktuar prej saj. Kështu, pavarësisht se isha i vetëdijshëm se ky vendim do të më kushtonte humbjen e zgjedhjeve, unë zgjodha të zbatoj ligjin. Nëse unë apo qeveria e PD do të kishim patur lidhje me skemat piramidale, ne do të kishim pranuar të kthenim paratë e tyre dhe të qetësonim rebelimin që pasoi. Por ne bëmë atë që duhet të bëjë një qeveri e përgjegjshme. Sa më sipër provohet nga vlerësimi i ekspertit të FMN që Home Office ka cituar si

¹⁶ Home Office u referohet Culture Trip dhe Unheard (Aneksi B, §13, 14, 20, 28, 131), për të cilat deklarohet se nuk janë media formale që ofrojnë mbulim të lajmeve. Në fakt e para, është platformë që ofron shkrime për udhëtimet turistike. Shkrimet e saj ofrojnë sygjerime udhëtimesh dhe nuk ofron mbulime apo analiza politike, si dhe nuk pretendon të ketë këtë profil gazetarësh (<https://comms.theculturetrip.com/about/>). Për më tepër, drejtues të rëndësishëm të portlit pranojnë gjenerimin e artikujve nëpërmjet inteligjencës artificiale (<https://medium.com/global-editors-network/culture-trip-a-business-model-combining-media-and-travel-9015dd2fb54>). Gjithashtu ranojnë se boton artikuj të sponsorizuar dhe dhe e kanë të pamundur të kontrollojnë përmbajtjen e të gjithë postimeve (<https://www.forbes.com/sites/samshead/2019/07/04/culture-trip-ceo-opens-up-about-bad-reviews-i-cant-say-i-find-it-easy-to-read-that-stuff/#342a7e0e5dbc>). Sa më sipër shpjegon faktin se artikulli i saj nuk ofron asnjë fakt apo detaj, por vlerësime të përgjithshme dhe për pasojë pa asnjë vlerë prove. Artikulli i UnHerd bazohet në intervista të përfaqësuesve të Fondacionit Soros, ministrave socialistë dhe Erion Veliajt dhe reflekton anshmëritë e tyre. Edhe citimet e këtij artikulli përmbajnë vlerësime të përgjithshme, pa emra apo ngjarje, të cilat nuk mund të konsiderohen si prove, pasi asnjë përgjigje nuk mund të jepet për to. Për më tepër, të dy artikujt përmbajnë deklarata të pabazuara, totalisht në kundërshtim me realitetin dhe me faktet, ligjore apo publike, të botuara në media dhe publikisht të njohura. E vetmja reference që mund të debatohet është një artikulli një eksperti të FMN-së, i cili ka shërbyer në misionin e FMN-së në Shqipëri gjatë periudhës së skemave piramidale. Ky artikull në fakt dëshmon të kundërtën e qëndrimit të Home Office: [Finance & Development, March 2000 - The Rise and Fall of Albania's Pyramid Schemes \(imf.org\)](#). Citimet janë nga variant më i detajuar: [IMF Staff Papers - Vol. 47, No. 1, March 2000](#). Për një përshkrim më të plotë të argumentave shih §27-30 të raportit (variant i zgjeruar).

¹⁷ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë, nr. 3450, datë 30.04.1996. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 467, datë 5.2.1997.

prove kryesore¹⁸. Në raportin e tij të titulluar “The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania”, ai shkruan se, fillimisht autoritetet shqiptare dhe FMN i konsideruan këto skema si beninje, me investime reale fitimprurëse dhe kontributorë në rritjen ekonomike të vendit¹⁹, dhe se për këtë arsye, “...një mision i FMN-së me mision këshillimin për problemet e sektorit financiar, në fund të vitit 1995 u fokusua më së shumti në mundësitë për përmirësimin e sistemit financiar formal duke integruar elementët më pozitivë të tregut informal”²⁰. Po aty ai shprehet se autoritetet shqiptare bënë një punë mjaft të mirë në trajtimin e skemave piramidale pasi ato u identifikuan, ku veprimet më të mira ishin refuzimi për të financuar detyrimet e firmave me para të buxhetit, si dhe ngrirja e aseteve në sistemin bankar të dy kompanive me më shumë depozitues²¹.

Por gjithashtu, edhe më i rëndësishëm është vlerësimi i parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, që e cilëson qëndrimin tim dhe të qeverisë së PD si vlerësimin e duhur ligjor. Ky Parlament në raportin e tij me titull *The Largest Heist In History. Building the Great Pyramid: The Global Financial Crisis Explained*²² të publikuar në vitin 2009, kushtuar kolapsit, të skemave të investimit që pllakosën City dhe banka të tjera në Londër (2008), ndër të tjera shkruan se, bankierët e financierët e këtyre skemave vepruan njësoj si gangsterat shqiptare të skemave të viteve 96-97 dhe se qeveria britanike u pajtua me kërkesat e tyre, injektoi sasi të paprecedent parash dhe garancish në këto skema, gjë të cilën, në vitin 1997, qeveria shqiptare nuk e bëri. Raporti thekson se biznesi që dështon duhet të lihet të falimentojë dhe se ndërtimi i skemave piramidale është i paligjshëm dhe drejtuesit e tyre duhet të ndiqen penalisht²³.

7-Absurditeti arrin kulmin kur Home Office citon si prova kundër meje disa raporte ndërkombëtare që prekin çështjet e korrupsionit në Shqipëri, të cilat i referohen ekskluzivisht periudhës kohore të qeverisë së Ramës dhe nuk kanë të bëjnë fare me Berishën dhe qeverinë e tij²⁴. Apo raporte të tjerë, që pavarësisht nga titulli i tyre, e ilustron kapjen e shtetit vetëm me shembuj që i përkasin qeverisë së Ramës, ndërsa në lidhje me periudhën e qeverisjes së PD përmendin proceset gjyqësore ndaj tre ministrave të qeverisë. Në fakt, në kontrast të thellë me qeverisjen e PS, gjatë periudhës së qeverisjes së PD, imuniteti i ministrave dhe deputetëve është hequr sa here prokuroria e ka kërkuar një gjë të tillë dhe ministrat i janë nënshtruar procesit gjyqësor. Përveç kësaj ne hoqëm me ligj imunitetin e zyrtarëve për çështjet e korrupsionit²⁵. Home Office përmend gjithashtu Raportet e Të Drejtave Të Njeriut të Departamentit të Shtetit (2007 – 2010). Këto raporte, ndërkohë që përcjellin problemet e trashëguara dhe të vazhdueshme, tipike për çdo demokraci në zhvillim,

¹⁸ The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania, *IMF Staff Papers - Vol. 47, No. 1, March 2000* Faqe 25, 27.

¹⁹ Idem, fq. 6.

²⁰ Idem, fq. 6-7.

²¹ Idem, fq. 27.

²² *The Largest Heist In History. Building the Great Pyramid: The Global Financial Crisis Explained*. Memorandum nga Greg Pytel. Shkurt 2009.

<https://publications.parliament.uk/pa/cm200809/cmselect/cmtreasy/144/144w254.htm>

²³ Për më gjerë shih paragrafët 27 – 30 të raportit (variant i zgjeruar).

²⁴ Citime të Home Office

https://www.scribd.com/document/427073869/HOUSE-OF-LORDS-The-UK-and-the-future-of-the-Western-B*alkans-pdf#

<https://www.state.gov/reports/2019-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

²⁵ [2021 Report DeconstructingStateCaptureAlbania English.pdf \(transparencycdn.org\)](#)

theksojnë gjithashtu përpjekjet e dallueshme të Berishës dhe qeverisë së tij, si dhe arritjet e tyre, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për ironi te fatit, ndër ata që kanë vlerësuar më shumë këto arritje është Antony Blinken, gjatë vizitës sime si kryeministër në Shtëpinë e Bardhë, kur ai ka qenë këshilltar për sigurinë kombëtare i zëvendës presidentit Joe Biden²⁶.

Këto ishin provat për akuzat për korrupsion që Home Office ka paraqitur kundër meje ndërkohë që në vitet e qeverisjes së PD ka patur korrupsion, por ka patur edhe një luftë të vendosur kundër tij. Shqipëria hoqi nga kushtetuta imunitetin e politikanëve për këtë veprë penale, vendosi one stop shop për lejet dhe liçensat, plotesoi kushtet për pragun e Millennium Challenge Corporation, u bë vendi i parë në botë me sistem dixhital të plotë të prokurimeve publike të çertifikuar nga OKB dhe u nderua nga kjo organizatë me çmimin e dytë në botë për transparence²⁷. Falë kësaj lufte, Shqipëria njohu rritje të GDP *per capita* dhe në një *quantum leap* të vërtetë kaloi nga grupi i vendeve me të ardhura të ulta, në grupin e vendeve me të ardhura të mesme – të larta, ndërtoi dhe rindërtoi mbi 11 mijë km rrugë, dyfishoi rrogat dhe pensionet, trefishoi investimet e huaja dhe eksportet²⁸.

8- Në deklaratën time të datës 21 korrik 2022, theksova se vendimi i Home Office mund të jetë marrë në kuadrin e Five Eyes Treaty si një detyrim ndaj SHBA. Por ambasadori King Smith me një prononcim në media hodhi poshtë këtë pretendim timin dhe u shpreh se MB kishte motivet e veta për perjshtimin tim²⁹.

Në kontrast me këtë qëndrim të ambasadorit, Home Office pohon se vendimi për përjashtimin e Berishës duhet marrë në mbeshtetje të vendimit të Departamentit Amerikan të Shtetit³⁰.

Vë në dukje se, me datën 19 maj 2021, 8 vite pasi kisha dhënë dorhëqjen nga çdo rol drejtues në PD, dhe katër javë pasi partia PD humbi zgjedhjet e pergjishme, si dhe pas kundërshtimit tim të prerë për një koalicion të mundshëm midis saj dhe Partisë Socialiste në pushtet, gjë që do t'a linte vendin pa opozitë, Sekretari Blinken pa asnjë provë, dokument, apo akuzë zyrtare, në një vendim të mirëfilltë politik, më shpalli mua, bashkëshorten dhe fëmijet e mi *non grata* për korrupsion domethënës. Por gjatë këtyre dy viteve, DASH nuk u ka paraqitur dot asnjë provë të vetme kongresmenëve dhe mediave të SHBA të cilët, jo vetëm i kanë kërkuar ato, por edhe kanë denoncuar lobimin dhe ndërhyrjen e George Soros për llogari të Edi Rames në dezinjimin tim. Kongresmeni Lee Zeldin i deklaroi Sekretarit Blinken gjatë një dëgjese se vendimi për përcaktimin non grata të Berishës vinte nga hiçi, pasi pas hetimeve të tyre ata nuk kanë gjetur asgjë për

²⁶ <http://arkiva.km.gov.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=10337&gj=gj1>
<https://a2news.com/2021/05/19/ne-vitin-2009-blinken-vleresonte-kryeministrin-berisha-ne-luften-kunder-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar/amp/>
<https://opinion.al/ne-vitin-2009-blinken-vleresonte-berishen-per-luften-kunder-korrupsionit/>
<https://dosja.al/dje-e-shpalli-non-grata-si-e-vleresonte-blinken-berishen-per-luften-kunder-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar-deklarata-e-vitit-2009-qe-ruhet-edhe-sot>

²⁷ 2010 United Nations Service Award for improving transparency, accountability, and responsiveness in public service.
<http://arkiva.km.gov.al/skedaret/Shqiperia-UNAward.pdf>

²⁸ Shih paragrafët 31 – 35 të raportit (variant i zgjeruar).

²⁹ Për më tepër informacion mbi pikën 8, shih paragrafet 36 – 36.14 të raportit (variant i zgjeruar).

³⁰ OPEN Summary of Exclusion decision – Sali Berisha, id., pg.1 (iii), pg. 2 (vi), pg. 8§25, OPEN Summary of Exclusion decision – Sali Berisha, Annex 1, §24. Annex B §135

korupsion në lidhje me Sali Berishen, dhe se vendimi për përcaktimin e Berishës është i ndikuar nga Xhorxh Soros. Kongresmeni Lee Zeldin i dërgoi tri letra, në periudha të ndryshme, ku I kërkonte Sekretarit Blinken provat mbi të cilat ishte marrë vendimi për përcaktimin e Berishës non grata dhe nuk mori asnjë dokument apo fakt konkret nga Departamenti i Shtetit³¹. Ish drejtori në detyrë i DNI dhe i ngarkuar i Presidentit për Ballkanin, Richard Grenell, e ka cilësuar vendimin e Sekretarit Blinken, si një vendim qartësisht politik e militant kundër një partie konservatore, dhe gjithashtu ka pohuar se gjatë kohës së tij në detyrë ai kurrë nuk ka parë ndonjë dosje që të akuzonte Berishën për korupsion³².

Dokumenta zyrtare të drejtësisë amerikane dhe mediat e huaja kanë raportuar se Edi Rama ka korruptuar ish shefin e kundërzbulimit të FBI për New York, Charles McGonigal³³, gjatë kohës që ai ishte në detyrë, dhe se e ka përdorur atë dhe ekipin e tij për përgatitjen e dosjes sime³⁴. Shtoj se njëjloj si McGonigal, por me mjete politike, u angazhua në luftën për shkatërrimin e opozitës edhe ambasadorja e SHBA Juri Kim, e cila për shkak të luftës së saj anti – opozitare, jo rrallë është konsideruar si sekretare të PS të Shqipërisë³⁵.

Në lidhje me vendimin e sekretarit Blinken kundër Sali Berishës, Këshilli i Ambasadorëve Amerikanë³⁶, në një raport të botuar së fundmi, në vijim të një misioni faktmbledhës në Ballkanin Perëndimor, në Maj 2023, thekson (nënvizimi i shtuar) se³⁷:

“Në maj 2021, sekretari amerikan i shtetit, Antoni Blinken, duke vepruar sipas këshillës së Ambasadës së SHBA, e përcaktoi ish presidentin (1992-1997) dhe ish kryeministrin (2005-2013) Sali Berisha – i cili udhëhoqi qeverinë e parë post komuniste dhe e drejtoi vendin në rrugën e demokracisë – si të përjashtuar në mënyrë të përhershme nga përshtatshmëria për të hyrë në SHBA. Seksioni 7031(c) i ligjit të Departamentit të Shtetit, dhe Buxhetimit të

³¹ <https://lapsi.al/2021/06/08/non-grata-e-berishes-kongresmeni-leter-dash-kerkoj-nje-shpjegim-te-detajuar-mbi-procesin-e-ndjekur/>
<https://politiko.al/english/e-tjera/berisha-non-grata-kongresmeni-amerikan-i-shkruan-letren-e-trete-dash-it-i448425>

Për referenca të plota shih paragrafët 36 – 36.14 të raportit (variant i zgjeruar).

³² Richard Grenell, ish-drejtori në detyrë i Inteligjencës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara <https://politiko.al/e-tjera/grenell-per-sanksionimin-e-berishes-skame-pare-dosje-ne-dash-blinken-i-p-i483586>

³³ <https://www.nytimes.com/2023/02/03/nyregion/fbi-intelligence-charged-albania.html>

³⁴ [Hunter Biden's link to disgraced ex-FBI official Charles McGonigal \(nypost.com\)](https://nypost.com/2023/02/03/hunter-biden-link-to-disgraced-ex-fbi-official-charles-mcgonigal/)

Gazetari gjerman, Herbert Bauernebel, korrespondent i gazetës Bild në New York, deklaroi në një intervistë për Syri TV ([here](https://www.syri.net/op-ed/603344/yuri-kim-po-iken-si-nje-hije-e-zeze-nga-shqipëria/)), se rasti i Sali Berishës është interesant pasi sipas dokumenteve të Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së dhe hetimeve të gazetareve amerikanë, rezulton se McGonigal është përfshirë në operacionin e caktimit non grata të ish-presidentit dhe kryeministrit Sali Berisha. Në lidhje me rolin e Rossini -t shih, [Ekskluzive në Top Story/ Mark Rossini kritika të forta: Berisha po bëhet kukull e Putinit - Top Channel \(top-channel.tv\)](https://www.syri.net/op-ed/603895/yuri-shqiptareve-u-ke-ngrene-buken-dhe-u-ke-permbysur-kupen/).

[Q&A Rama/McGonigal: the plot behind the effort to eradicate the DP \(campaign-archiv.com\)](https://campaign-archiv.com/2023/07/01/ambasadorja-e-be-hohmann-ajo-qe-shkateroi-modelin-yuri-kim/) Për referenca të tjera shih paragrafin 36.14 të raportit (variant i zgjeruar).

[Lucas: Follow the \\$ through case of spies & State Dept. \(bostonherald.com\)](https://www.bostonherald.com/2023/07/01/lucas-follow-the-dollar-through-case-of-spies-and-state-dept/)

³⁵ <https://www.syri.net/op-ed/603344/yuri-kim-po-iken-si-nje-hije-e-zeze-nga-shqipëria/> <https://www.syri.net/op-ed/603895/yuri-shqiptareve-u-ke-ngrene-buken-dhe-u-ke-permbysur-kupen/>
<https://lapsi.al/2023/07/01/ambasadorja-e-be-hohmann-ajo-qe-shkateroi-modelin-yuri-kim/>

³⁶ Sipas faqes së tij të internetit, Këshilli i Ambasadorëve Amerikanë (the Council of American Ambassadors) është një organizatë jo-fitimprurëse dhe jo politike e ambasadorëve amerikanë jo- të karrierës të emëruar në gjashtë dekada nga 11 presidentë amerikanë, që organizon tavolina debatesh me ambasadorët në SHBA, organizon misione faktmbledhëse jashtë vendit, publikon një revistë gjashtë-mujore *American Ambassadors Review* dhe drejton programe edukuese në fushat e politikës së jashtme dhe interesit kombëtar.

³⁷ Nxjerrë nga raporti, i shkarkuar në 13 mars 2024, nga [Council of American Ambassadors](https://www.councilofambassadors.com/)

Operacioneve të Huaja 2021, i dha sekretarit të shtetit Blinken dhe sekretarëve të ardhshëm, tagrin për të përcaktuar kësisoj një individ dhe familjen e tij/saj, në bazë të provave mbi kriminalitetin dhe korrupsionin të paraqitura dhe vlerësuara në seancë të mbyllur (in camera), pa mundësi kundërshtimi. Mbretëria e Bashkuar pasoi vendimin dhe Berisha pranoi në mes të vitit 2022 se ai nuk ishte më i përshtatshëm për të udhëtuar në Mbretërinë e Bashkuar. Mbi këtë bazë, Lulzim Basha, kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, e përjashtoi Berishën nga partia, duke shkaktuar një ndarje në partinë më të madhe opozitare përpara zgjedhjeve lokale.

Një sërë antarësh të delegacionit tonë e pyetën nga afër ambasadorin Kim dhe anëtarët e stafit të saj mbi vendimin për t'i ndaluar hyrjen Berishës në SHBA dhe kohën e këtij vendimi, duke kërkuar:

- *të dhëna se çfarë provash mund të justifikonin një veprim të tillë përfundimtar dhe kaq gjithëpërfshirës kundër një politikani, dikur të afërt me SHBA;*
- *informacion nëse persona të tillë të akuzuar kishin pasur ndonjëherë mundësi të përdornin mekanizma për të kundërshtuar akuzat apo provat;*
- *nëse në këshillat për sekretarin Blinken ishin vlerësuar katërcipërisht shfaqja e ndërhyrjes elektorale dhe favoritizmi;*
- *precedentë në zbatimin e kësaj politike në raste të ngjashme.*

Ambasadorja Kim dhe stafi i saj na siguruan se provat për të mbështetur këtë vendim ishin të shumta, por na komunikuan prerë se nuk mund të na tregonin ndonjë prej tyre. Ata gjithashtu pranuan se procesi ishte tërësisht i mbyllur (in camera), pa mundësi kundërshtimi dhe pa të drejtë apelimi. Kjo është jashtëzakonisht e rrallë, nëse jo unike, në jurisprudencën e SHBA. Simpatizantët e Berishës u ankuan se përcaktimi i tij ishte i ngjashëm me procedurat e Dhomës Star³⁸, në antitezë me traditën amerikane të procesit të rregullt. Githësesi, ambasadorja Kim na shpjegoi privatisht se lufta ndaj korrupsionit ishte e një rëndësie të atillë thelbësore për politikën e SHBA-së dhe e një prioriteti aq të lartë saqë zyrtarë të administratës Biden e kishin konsideruar të rëndësishme të bënin shembull dikë, për të theksuar se askush nuk është mbi ligjin apo imun kur bëhet fjalë për krime korrupsioni. Ne e dime se Berisha është 79 vjeç dhe, duke qenë pranë fundit të jetës së tij politike, mund të konsiderohet nga disa si një figurë e zëvendësueshme në politikë, por të sulmohet dike tjetër për ti dhënë mësim fajtorit të vërtetë nuk është mënyra amerikane e drejtësisë. Kjo ngjason më shumë me fjalën e urtë kineze “vrit pulat që të trembësh majmunët”. Berisha ka bërë padi në Francë kundër sekretarit amerikan të shtetit dhe përfaqsohet falas në Washington nga një lobist i shquar.”.

9- Home Office pretendon se vendimi i saj nuk është koordinuar dhe nuk synon të mbështesë Edi Ramën. Por faktet flasin ndryshe³⁹.

Së pari lajmin e përjashtimit tim nga MB e njoftoi i pari Edi Rama në parlament⁴⁰.

Së dyti, ambasadori King Smith që nga vjeshta e vitit 2021 ndërmori fushatë aktive kundër meje,

³⁸ Star Chamber, gjykatë e shekujve 15-17, e krijuar për të gjykuar aristokracinë e fuqishme dhe shpesh anti-monarkike, e cila gjykonte në seanca të mbajtura në fshehtësi dhe me mjete që përfshinin torturën. Termi procedurë e Dhomës Star, përdoret sot si sinonim i një procesi gjyqësor arbitrar dhe të padrejtë.

https://www.law.cornell.edu/wex/star_chamber_proceedings#:~:text=Star%20chamber%20proceeding%20is%20a,arbitrary%20and%20unfair%20adjudicatory%20proceeding.

³⁹ Për argumenta dhe referenca të plota shih paragrafet 37 – 49 të raportit (variant i zgjeruar).

⁴⁰ <https://gazetasi.al/non-grata-edhe-nga-britania-rama-paralajmeron-serish-berishen/>

duke u përpjekur të bindte bashkëpunorët e mi që të mos mbështesnin iniciativën time që synonte rithemelimin e Partisë Demokratike dhe çlirimin e opozitës nga kontrolli i qeverisë.

Së treti, ai pasi ka mashtruar qeverinë e tij me dokumentet që i serviri asaj, troket tani në dyert e institucioneve shqiptare dhe kërkon fakte për shpifjet e tij kundra meje, duke thënë se "...n'a duhen fakte pasi rrezikojmë të humbim çështjen në gjykatë".

Së kateri, zoti King – Smith në një shkresë që i drejton qeverisë së tij⁴¹, e mashtron atë, duke i shkruar se, pas urdhërit të përjashtimit, Berisha ka nisur sulme publike kundër qeverisë Britanike. Në të vërtetë unë si njeriu që kam rivendosur marrëdhëniet diplomatike dhe zgjidhur të gjitha problemet e trashëguara nga diktatura e Enver Hoxhës me këte vend mik, nuk kam sulmuar kurrë qeverinë britanike dhe kjo është një sajese mjerane. Madje edhe pas vendimit të saj absurd kundra meje unë gjatë krizës së refugjatëve shqiptarë kam kundërshtuar publikisht sulmet e pa baza të Edi Rames ndaj saj. Deklaratat e mia janë pasqyruar në mediat shqiptare⁴² dhe ato të BM⁴³.

Së pesti, po në këtë shkresë z King Smith i vetëdijshëm për fallsitetin e provave që i ka derguar Home Office shkruan se, heqja e përjashtimit të Berishës qoftë nga gjykata ose para vendimit të kësaj të fundit nga Home Office, dëmton reputacionin ndërkombëtar të Britanisë së Madhe. Kështu ai injoron drejtësinë, ligjin dhe ndershmërinë si elemente thelbësore të reputacionit të vendit të tij dhe kërkon ruajtjen e reputacionit duke mbajtur një vendim të bazuar jo në prova, por në mashtrime dhe korrupsionin e tij. Madje, ai për këtë qëllim përdor edhe argumenta politike dhe pohon se, rreziku i dëmtimit të reputacionit të qeverisë britanike nga heqja e përjashtimit bëhet edhe më i madh për shkak të zgjedhjeve lokale në Shqipëri, si dhe sulmeve të Edi Rames kundër qeverisë së MB për çështjen e refugjatëve. Mendoj se këto deklarata nuk kanë nevojë për komente.

Se gjashti. opinionin publik dhe media në Shqipëri kanë vënë në dukje se ambasadori King - Smith, duke ndjekur linjën e veprimit të qeverisë së Edi Ramës, punon kundër opozitës shqiptare dhe duke e bërë këtë, dëmton mekanizmat e kontrollit dhe balancës që ofron një opozitë e vërtetë në çdo shoqëri demokratike⁴⁴. Në kontrast të thellë nga përjasja e tij me opozitën shpaloset qëndrimi i z. King Smith ndaj qeverisë, të cilën mediat e kanë vënë vazhdimisht në dukje si një sjellje të pazakontë⁴⁵.

Si konkluzion, të gjitha dokumentat dhe provat që Home Office ka paraqitur për të mbështetur përjashtimin tim janë kryekëput të bazuara në shpifje, interpretime të pavërteta të artikujve të mediave të kontrolluara nga George Soros dhe akuza të pa baza të kundërshtarëve të mi politik. Ato në asnjë moment nuk provojnë asnjë lidhje me krimin dhe asnjë lloj shkelje ligjore, apo përfitim të paligjshëm nga unë, familjarët e mi, PD apo personat e tjerë që përmenden në to.

⁴¹ Annex G

⁴² <https://politiko.al/ditari-i-opozites/pd-demon-gjuhen-e-rames-berisha-britanise-analizoni-pse-shqipt-i470104>

⁴³ <https://www.dailymail.co.uk/news/article-11421577/Albanians-streets-demonstrate-against-government-rising-cost-fuel-food.html>

⁴⁴ <https://www.syri.net/politike/577614/mediat-britanike-groposin-ramen-ambasadori-do-te-gropose-opoziten/>
<https://boldnews.al/2022/10/14/diplomacia-e-erret-si-punoi-ambasadori-britanik-kunder-opozites-faktet/>

⁴⁵ <https://dosja.al/politike/king-smith-alastair-king-smith-si-deperto-i-mes-socialisteve-ambasadori-i249565>
<https://www.podiumi.com/2021/10/11/vetem-ne-shqiperi-behen-ambasadoret-e-huaj-guvernator-e-vip-a-se-ne-britani-dhe-kudo-ne-perendim-nuk-i-njeh-as-komshiu/>

Ndaj, përjashtimi im është një rast klasik i përdorimit me sukses nga qeveria e Edi Ramës të korrupsionit transnacional, për të sanksionuar kundërshtarët politikë, shkatërruar opozitën dhe për të mbrojtur kësajsoj, korrupsionin dhe lidhjet e tij dhe qeverisë së tij me krimin.

Sanksionimi im ka patur si qëllim madhor së pari, të zhvlerësojë dhe të bëjë të pabesueshëm një zë që ka denoncuar dhe denoncon, me shumë se kushdo tjetër, me dhjetra e qindra afëra korruptive të qeverisë më të korruptuar në Europë, përfshi këtu aferat e mëdha si ajo e djegësave, Portit të Durrësit, të cilat janë denoncuar së fundmi edhe nga Parlamentit Europian dhe Departamenti i Shtetit.

Së dyti, sanksionimi është një mjet që kërkon të zhvlerësojë zërin që ka denoncuar përsëri me shumë se kushdo tjetër lidhjet e Edi Rames dhe qeveritarëve të tjerë me krimin dhe kartelet e drogës në Shqipëri, Sinaloa e Meksikës dhe vendet e tjera në botë⁴⁶ si dhe kthimin e Shqipërisë ndër vendet e para në botë, sipas OKB, për prodhimin dhe trafikimin e kanabisit⁴⁷. Në dhjetor 2023, gazetari Elton Qyno, i cili kish bërë hetime të thelluara mbi përdorimin e telefonave SKY ECC nga grupet shqiptare të krimit të organizuar⁴⁸, u ndalua për t'u pyetur nga Prokuroria e Posacme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK). Shtëpia e tij u kontrollua dhe iu sekuestruan disa telefona dhe kompjutera. Avokati i z.Qyno deklaroi se këto masa ishin marrë sepse z.Qyno dispononte informacion se këto telefona të enkriptuar ishin përdorur nga zyrtarë të lartë të qeverisë, duke përfshirë kryeministrin Rama, kreun e mëparshëm të policisë Ardi Veliu, zyrtarë të institucioneve të vetingut, si dhe përfaqësues të tjerë të qeverisë⁴⁹. Prandaj, vendimi i pabazë i Home Office paraqet një rast tipik të përdorimit të sanksioneve, jo për të dekurajuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, por për hakmarrje tipike politike.

Se treti, korruptimi i ambasadorit King Smith dhe parardhësit të tij, njelloj si McGonigal, u përdorën nga qeveria si armë për shkatërrimin e opozitës dhe konsolidimin e regjimit monist të Edi Rames në Shqipëri. Shkatërrimi i opozitës është vrasja e shpresës dhe shkatërrimi i një shoqërie të lirë. Sot politikat e regjimit të Edi Ramës, i kanë shndërruar shqiptarët edhe në vitin 2023 në *boat people*. Sipas Eurostat, gjatë viteve 2014-2021, 937000 qytetarë janë larguar nga Shqipëria drejt hapsirës Shengen.

⁴⁶ <https://dosja.al/politike/fotot-ekskluzive-rama-prit-ne-zyre-ortaket-e-kartelit-sinaloa-i242770>
<https://www.washingtonexaminer.com/opinion/bidens-strange-tolerance-for-albanias-narcostate> <https://politiko.al/e-tjera/gazetari-amerikan-rama-i-lidhur-me-kartelin-sinaloa-i474934> <https://ndiqparate.al/?p=18310>

⁴⁷ <https://lapsi.al/2023/07/03/ne-2021-ne-shqiperi-u-prodhua-3600-ton-kanabis-rekord-nga-2016/>

⁴⁸ <https://24-ore.com/elton-qyno-komunikimet-ne-sky-ecc-jane-te-egra-te-etura-per-gjak/>
<https://boldnews.al/2023/10/03/nuk-lokalizoheshin-dot-gazetari-sky-nuk-ka-lidhje-me-valet-e-antenes-por/>

as downloaded on 16 March 2024.

⁴⁹ <https://www.mcntv.al/2023/12/15/hetimi-p-r-gazetarin-llangozi-do-t-plaste-bomba-e-madhe-p-rmendet-rama-tar-t-vingut-dhe>
https://www.mcntv-al.translate.goog/2023/12/15/hetimi-p-r-gazetarin-llangozi-do-t-plaste-bomba-e-madhe-p-rmendet-rama-tar-t-vingut-dhe?_x_tr_sl=sq&_x_tr_tl=en&_x_tr_hl=en&_x_tr_pto=wapp
<https://boldnews.al/2023/12/27/avokati-llangozi-spak-po-fsheh-pergjimet-ku-del-dhe-edhi-rama/>

as downloaded on 16 March 2024.

